



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Kuvendi i Komunës Klinë

Komiteti për Komunitete

01Nr. 06-14538 2024

Klinë, dt. 29.04.2024

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e rregullt e punës së Komitetit për Komunitete të mbajtur me datë 09. 01. 2024 në ora 10:00 në Sallën e Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e hapi kryesuesja e komitetit znj. Besiana Gashi duke përshëndetë të gjithë të pranishmit.

Duke uruar që ky vit të jetë vit i sukseseve, Kryesuesja prezantoj Rendin e ditës.

Për Rendin e ditës u hap debat.

Me vota unanim u miratua Rendi i Ditës.

Pika 1 e Rendit të Ditës: Arsyetimi i mungesave

-Të pranishëm janë 5 anëtarë të komitetit. Mungon znj Kerrela dhe z. Limanaj por që janë rrugës për në mbledhje.

Pika 2 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.

- Me 5 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRUA.

Pika 3 e Rendit të Ditës: Informim rreth punës së Inspektoratit në Komunën e Klinës.

z. Dardan Bashota, zyrtar në drejtorinë e inspektoratit: Ju përshëndes të gjithëve. Puna e inspektoratit bazohet në zbatimin e ligjshmërisë. Në lëmine e shërbimeve publike, ndërtimit, bujqësisë, trafikut dhe tregut. Fillimisht më lejoni të theksoi se drejtoria e inspektoratit e ka shfrytëzuar buxhetin në vlerën prej 99.8%. Ndërsa të hyrat nga gjobat dhe të tjera janë në shumën prej 20.462,00 euro. Në drejtorinë e inspektoratit janë bërë kërkesa të ndryshme gjithsejtë 288, 8 janë refuzuar, 2 janë anuluar të tjerat janë zgjedhur.

z. Bashota në vazhdim tregoj në detaje nëpër çdo dikaster të inspektoratit për inspektimet e bëra dhe gjobat e shqiptuara gjithashtu edhe për vendimet e marrura.

“Në pika të shkurtra është ky një raport i shkurtër i drejtorisë komunale të inspektoratit për vitin 2023 dhe mund të them se është arritur realizimi i planit të punës në masën 99%”, tha në fund të fjalës së tij

z. Dardan Bashota.

Znj. Besiana Gashi, kryesuese: Kam nj pyetje. Në kuadër të mbrojtjes së mjedisit a keni bërë shumë inspektime, a keni arritur që të inspektoni deponitë ilegale?

z. Dardan Bashota, zyrtar i Drejtorisë së inspektoratit: Identifikimi i deponive ilegale bëhet bashkë me agjensionin e mbrojtjes së mjedisit. 31 deponi të tilla janë në territorin e Klinës. Prej këtyre 7 deponi të vogla i kemi larguar por kemi probleme me deponin që është tek Dollci që është një nga deponitë më të mëdha. Ajo që duhet të largoj deponitë është drejtoria e shërbimeve publike përmes sektorit të veçantë për këtë çështje.

Znj. Besiana Gashi, kryesuese: Sa po arrihet të respektohet ligji për ndalimin e pirjes së duhanit në ambiente të mbyllura?

z. Dardan Bashota: Kjo është detyrë e AVUK, nuk është e inspektoratit komunal.

Znj. Besiana Gashi, kryesuese: Në rrugën magjistrale Prishtinë-Pejë tek rreth rrotullimi mbi urën e Drinit ka pasur shumë ndeshje komunikacioni, A keni ndërmarr deri tani ndonjë veprim që të minimizohen fatkeqësitë që po ndodhin aty?

z. Dardan Bashota: Sa kam informacion, drejtoria e infrastrukturës ka bërë kërkesë në ministrinë e infrastrukturës për vendosjen e disa shenjave treguese. Nga ministria nuk është kthyer akoma përgjigje.

Kryesuesja, znj. Besina Gashi e falënderoj për pjesëmarrje z. Dardan Bashota.

Pika 4 e Rendit ét Ditës: Shqyrtimi dhe aprovimi i planit të punës dhe arritja e marrëveshjes për orarin e takimeve për vitin 2024.

Kryesuesja tha se nëse ka dikush ndonjë koment për planin e punës që ju është dorëzuar paraprakisht. Me 7 vota për asnjë kundër dhe asnjë abstenim u MIRATUA

Pika 5 e Rendit të ditës: Informim nga zyra për komunitete dhe kthim

z. Halil Kerellaj, zyrtar në ZKK: Përshëndetje të gjithëve. Sa i përket personave të kthyer kemi një nga komuniteti Rom nga shati Dogujevë. Ky person është strehuar përkohësisht për 12 muaj. Në muajin dhjetor kemi pasur takim në lagjen mëhallë ku ka qenë prezent edhe kryetari i Komunës së bashku me drejtorin për shërbime publike. E kemi informuar Lagjen se brenda pak ditësh fillon ndriçimi publik të instalohet në lagje dhe ashtu edhe ka ndodhur. Në Muajin dhjetor kemi pasur punë me palë e sidomos në informimin e qytetarëve dhe ndihmën për regjistrim në platformën e Kosova. MAPL e pat hapur një thirrje për ndërtim dhe renovim të shtëpive, nga Kлина kemi pasur vetëm një që ka bërë kërkesë, ai është pranuar por fatkeqësisht ditën që ju ka dhënë lajmi ai ka ndërruar jetë. Nuk është bërë e mundur kalimi tek trashëgimtarët, ka mbetur pezull ai aprovim i aplikimit. Po ashtu kam informacion se shumë shpejtë

- të hapet edhe një thirrje për renovim dhe ndërtim. Nëse dikush ka pyetje nga anëtarët e kuvendit jam gati të përgjigjem.
- z. Nexhmedin Gashi: Familja e komuniteti Rom që është riatdhesuar, ku është sistemuar dhe çfarë kushtesh ju aknë ofruar?
- z. Halil Kerelaj, ZKK: Është sistemuar afër stacionit të trenit dhe kushtet bashkërisht me personat përgjegjës nga niveli qendror ja kemi siguruar, personi i kthyer është i kënaqur.
- z. Vehbi Alaj: Përshëndetje. Thatë që personit që ju ka pranuar kërkesa për ndërtim të shtëpisë ka ndërruar jetë. Nëse ai ka vdekur të tjetër jetojnë, sa është e mundur që të vazhdohet ndërtimi i asaj shtëpie.
- z. Halil Kerellaj, ZKK: Personi që ka vdekur ai ka qenë i ndarë me bashkëshorten. Kështu që ajo nuk ka mundur të përfitoj këtë projekt. Fëmijët janë nga dy bashkëshorte dhe ka mbetur e paqartë se kush me e trashëguar. Nuk është gjetur rrugë ligjore që të i bartet e drejta një pësoni familjare.
- z. Vehbi Alaj: A kemi mundësi ne si komunë që mos ta humbim këtë rast por këtë aprovim për ndërtim të ja mundësojmë dikujt tjetër.
- z. Halil Kerellaj, ZKK: Jo nuk kemi pasur mundësi sepse kërkesa është bërë nga individi që i ka plotësuar kushtet.
- z. Nexhmedin Gashi: Ndoshta më e rrugës është që familja e personit ët ndjerë të bëjë një autorizim tek një anëtar.
- z. Halil Kerellaj, ZKK: Nuk kanë rënë dakord se kush me e pas autorizimin.
- z. Djuro Krasiq: Në lagjen tonë ndriçimin publik pasi që e kanë rregulluar prap është prishur, është mirë që drejtoria përkatëse të kujdeset që pas përfundimit të projektit këtë ta merr përgjegjësi KEDS.
- z. Halil Kerellaj, ZKK: Nuk e diji se sa keni bërë kërkesë në zyrën tonë ose ne drejtorinë e Shërbimeve emergjente që ato drita të zëvendësohen. Është mirë që kërkesa të bëhet në mënyrë zyrtare pavarësisht raporteve të mira që i kemi.
- z. Nexhmedin Gashi: Në lidhje me ndriçimin publik më lejoni të jua bëjë një sugjerim. KA shumë vende që niset instalimi i ndriçimit dhe mbetet në gjysme që tre vjet ndërkohë që nisin procedura të reja [për instalime të tjera në lagje të tjera. Mirë do të ishte që para se të nisin projekte të reja nëpër lagje të përfundohet aty ku ka mbetur në gjysmë.
- z. Halil Kerellaj, ZKK: Mirë bëni që të përmendet vendi se ku kanë mbetur në gjysmë.
Për z. Kerellaj kishte pyetje dhe kryesuesja e komitetit në lidhje me një shtëpi në lagjen Klinac, aty brenda shtëpisë është e instaluar një shtyllë elektrike. Si ka mundësi të ndodhë kjo, të mbetet në mes të shtëpisë shtylla elektrike.

- z. Halil Kerellaj tha se nuk ka pasur ndonjë kërkesë nga familja në fjalë që të largohet ajo shtyllë.
Pika 6 e Rendit të Ditàs: Të ndryshme.
- z. Besiana Gashi, kryesuese tha se akoma vazhdon të mbetët pezull çështja e mos pagesës së mëditjes për anëtarët e komitetit, shpreson që periuudha janar shkurt do të jetë koha e zgjidhjes së këtij problemi.
- z. Vehbi Alaj: Unë dhe Nexhmedini patëm ra dakord që ta pezullojmë takimin sot dhe në vazhdim por në momentin e fundit vendosëm që paraprakisht të kërkojmë një takim me ministrin. Nëse ai nuk na pranon në këtë takim do të i ftojmë mediat dhe shqetësimin tonë do ta prezantojmë para mediave. Na takon me ligj që të i marrim mëditjet.

Procesmbajtës:

Skënder Behramaj

Kryesuesja:

Besiana Gashi